



Informata për prindërit e gjuhëve tjera

Të dashur prindë

Ju banoni në Kantonin St. Gallen ndërsa fëmiju i juaj vijon kopshtin e fëmijëve apo shkollën fillore (klasa 1 parë deri e nëntë). Për ,t' a njohur më mirë shkollën, mund t'u ndihmojë broshura që e keni përpara.

Interesohuni për detyrat e fëmijut të juaj, të cilat i kryen në shkollë dhe në shtëpi. Informohuni rregullisht te mësimdhënësi për përparimin, që bën fëmiju juaj, në mësim.

Një prej qëllimeve të shkollës është që fëmiju juaj të mësoj gjuhën gjermane; por kjo nuk do të thotë që ju në familjen e juaj mos t' a përdorni gjuhën amtare, sepse ajo është pjesë e pasurisë së juaj kulturore. Zotërimi i gjuhës gjermane dhe gjuhës së juaj amtare është shumë i rëndësishëm.

DEPARTAMENTI I EDUKIMIT
PËR KANTONIN ST. GALLEN
DIKASTERI I SHKOLLËS POPULLORE (Amt für Volksschule)
Davidstrasse 31
9001 St.Gallen

Prill 2003

Sistemi shkollor

Në komunën e juaj shkollore organizohet vijimi dyvjeçarë i Kopshtit të fëmijëve, të cilin mund ta vijoj fëmiju juaj. Shkollimi i obliguar përfshinë nëntë vite shkollore, prej të cilave 6 vite të shkolles primare dhe 3 vite të klasëve të larta (shkolla reale apo sekondare).

Fëmijtë që vijnë në Zvicër, zakonisht përcaktohen në një klasë, në të cilën mësojnë me moshatarët e tyre (zakonisht në një klasë më ultë).

Fëmijtë, të cilët kanë aftësi të kufizuara për sukses në mësim apo ndonjë pengesë e cila i pengon në vijimin e mësimin në klasë të rregullt, në marrëveshje me prindërit kalojnë në klasë të vogël. Mësimin në klasë të vogël e zhvillon arsimtari me arsimim special dhe secilit fëmijë i jep ndihmë individuale. Vetëm zotërimi i pamjaftueshëm i gjuhës gjermane nuk është shkak i dërgimit të fëmijut në klasë të vogël. Ju si prindë mund të kërkonit testimin nga një profesionist i Shërbimit shkollor psikologjik. Testimi pa pëlqimin dhe dëshirën e juaj nuk mund të bëhet.

Fëmijët me probleme të veçanta gjuhësore dhe drejtëshkrimore ndihmohen me terapi të logopedisë apo legastenisë. Fëmijët e hendikepuar vijojnë shkollat speciale.

Në qoftë se fëmiju gjuhën shkollore nuk e flet mirë, ka të drejtë gjatë tri vjetëve të para të vijimit të shkollës në mësimin plotësues të gjuhës. Kjo formë e mësimit organizohet në grupe të vogëla, ndërsa në komunat me numër të madh të fëmijëve dhe të rinjëve me gjuhë të huaja, mund të organizohet kjo formë e mësimit në klasë të veçanta, por më së gjati një vit (klasë të gjuhës gjermane; Deutschklassen).

Nga fundi i klasës së dytë e deri në fund të klasës së nëntë fëmiju merrë dy herë në vit dëftesën me nota (në muajin janar dhe korrik).

Shërbimi i përkëthimit

Për çështjet dhe problemet shkollore mund t' u informojë mësuesja apo mësuesi i klasës. Është e mundshme që ju si prindë keni nevojë për një person, i cili krahas gjuhës së juaj e flet edhe gjuhën gjermane dhe mundëson një kuptim më të mirë. Për çdo rast mësuesi apo mësuesja e klasës mund t' ua jep adresën e një përkëthyesi apo përkëthyesje. Shpenzimet e shërbimit të përkëthimit i bartë komuna shkollore.

Zgjedhja e profesionit

Pas përfundimit të shkollës popullore mund të bëhet mësimi i një profesioni apo një profesioni të përciptë (Anlere).

Të rinjtë bëjnë përgatitje në klasët e larta për zgjedhjen e profesionit. Ata mësojnë që me aftësitë e tyre të njohin profesione të ndryshme. Shkolla organizon ditë dhe javë provuese, gjatë të cilave të rinjtë krijojnë një parafytyrim për një profesion dhe për punën në një ndërmarrje. Këshillimorja për profesione ndihmon të rinjtë për zgjedhjen e profesionit real. Ata janë në dispozicion papagesë.

Parakushtet solide për mësimin e një profesioni janë rezultatet solide mësimore në shkollë dhe njohja e mirë e gjuhës gjermane. Gjetja e mësimi të një profesioni është kryesisht përgjegjësi e të rinjëve dhe prindërve të tyre. Nëqoftëse të rinjtë nuk gjejnë vendin për mësimin e një profesioni apo zanati, ekziston mundësia e vijimit të një viti paraprofesional (Vorlehjahr), (informatat mund ti merrni në Këshillimoren për profesione).

Të rinjtë me sukses të jashtëzakonshëm kanë mundësi që me dhënien e provimit pranues të vijojnë ndonjerën prej shkollave të mesme: shkollën kantonale (gjimnazin), shkollën e mesme ekonomike, diplomimin në shkollën e mesme.

Këshilla për edukimin dygjuhësor

Për integrimin e familjes, për ju si prindë, është e rëndësishme njohja e gjuhës gjermane të vendit. Përcillni të fëmiju juaj porosinë: që të dy gjuhët dhe kulturat janë pozitive, gjuha gjermane dhe gjuha amtare.

Në shtëpi flisni vetëm gjuhën e juaj amtare dhe qendroni pas saj edhe nëse flisni në dialekt.

Menjanoni përzierjen e gjuhëve; mos e vlerësoni negativisht, nëqoftëse këtë e bëjnë fëmijët.

U tregoni fëmijëve për fëmijërinë e juaj dhe përdorni shprehjet e gjuhës amtare çdo ditë.

Për mësimin e gjuhës shkollore gjermane, zotërimi i gjuhës amtare ka rëndësi të jashtëzakonshme.

Shikoni detyrat shkollore të fëmijës së juaj dhe kërkoni që ai t' i spjegoj në gjuhën amtare.

Dërgoni fëmijën e juaj në mësimin e gjuhës dhe kulturës amtare (Kurset e gjuhës dhe kulturës amtare) dhe kontrolloni përparimin e tij, duke shikuar së bashku librat e fletoret. (Adresat e Kurseve të gjuhës dhe kulturës amtare i shikoni në faqen e parë!).

Dy apo trigjuhësia nuk krijojnë pengesa. Vonesat e ndryshme gjuhësore rregullohen vetvetiu.

Të ndryshme

- *Dy herë nga gjysëm dite:* Prindërit kanë të drejtë që t' i shfrytëzojnë gjatë vitit shkollorë dy herë nga gjysëm ditë të lira për fëmijën e tyre psh. Pushimet e familjes, vizitë të afërmive e tjera. Për mungesa tjera të parapara, këtu hyjnë edhe festat fetare, duhet më parë të merret kërkesa për lirim nga mësimi te mësuesi apo mësuesja e klasës.
- Nëqoftëse fëmijë i juaj ka munguar për shkak të sëmurjes, mungesën duhet ta arsyetoj me shkrim dhe t' ia dorëzoj kujdestarit të klasës.
- Një herë në vit, mësimitdhënësit janë të obliguar që të zhvillojnë një bisedë me prindë. Data e bisedës shënohet në dëftesë.
- *Javët e jashtëzakonshme mësimore* si psh. Llogorimi apo zgjatja e mësimin janë pjesë me vlera në programin shkollor. Pjesëmarrja e fëmijës së juaj në këto organizime është e obliguar.
- *Puna e fëmijëve jashtë orarit të mësimin.* Sipas Ligjit federal nxënëset dhe nxënësit, që janë më të moshuar se 13 vjet, mund të punojnë ndonjë punë jashtë orarit të shkollës. Ju si prindë duhet t' a njoftoni kujdestarin e klasës.
- Shërbimi mjekësor i shkollës dhe Shërbimi dentar i shkollës do të kontrollojnë rregullisht e papagesë fëmijën e juaj.
- Moshë ligjore minimale për martesë me leje të prindërve është moshë 16 vjeçare.

Zyra për informacione

Udhëheqëja e shkollës :

Anëtari përgjegjës i Kuvendit të shkollës për gjuhët tjera:

Kryetari/Kryetarja e Komunës shkollore:

Këshillimorja për gjuhët tjera:

Reto Moritzi, Postfach 57, Stella Maris, 9400 Rorschach, Tel. 071 858 71 20

Këshillimorja profesionale:

Shërbimi shkollor psikologjik, enti regjional:

HSK

(Kurset e gjuhës dhe kulturës amtare):
